



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 261 Prot.

Tiranë, më 06 . 02 . 2025

**V E N D I M**

Nr. 31, Datë 06 . 02 . 2025

Bazuar në pikën 11<sup>1</sup>, të nenit 33, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup>,

**K O N S T A T O N:**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja “a”, dhe pika 3 e këtij neni, si dhe nenit 33 e 33/1, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka ndjekur të gjithë hapat që parashikon procedura e hetimit administrativ, për të shqyrtuar ankesën nr. 30 Regj., datë 23.02.2023, paraqitur nga z. A. D, kundër Shoqërisë “Illyrian Guard” sh a Tiranë, me pretendimin e diskriminimit për shkak të “konflikteve të krijuara në punë me Administratorin, për shkak të kundërshtimit të praktikave dhe procedurave të paligjshme nga ana e tij<sup>3</sup> ”.

Bazuar në nenin 33/10 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në përfundim të procedurës së hetimit administrativ, Komisioneri ka dalë me Vendimin nr. 156, datë 07.08.2023, me anë të të cilit ka vendosur: “Konstatimin e diskriminimit të subjektit ankues, A. D, në të drejtën për punësim, për shkak të konfliktit të krijuar mes tij dhe punëdhënësit, klasifikuar si “çdo shkak tjetër”, nga ana e Administratorit të Shoqërisë “Illyrian Guard” sha.”

<sup>1</sup> “Nëse Komisioneri urdhëron rregullime ose masa, personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, raporton brenda 30 ditëve para Komisionerit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit. Në rast se personi, kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk e informon Komisionerin ose nuk e zbaton vendimin, Komisioneri vendos masë për ndëshkimin me gjobë për personin kundër të cilit është paraqitur ankesa. Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni”.

<sup>2</sup> Në vijim do t’i referohemi si Komisioneri ose me akronimin KMD.

<sup>3</sup> Klasifikuar tek “çdo shkak tjetër”.

Në pikën 2 të këtij vendimi, Komisioneri ka vendosur: *“Në referim të pikës 1, Administratori i Shoqërisë “Illyrian Guard” sh.a, të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer subjektin ankues në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.”*

Pas marrjes dijeni të vendimit sipërcituar, Shoqëria “Illyrian Guard” sha i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar: *“Shfuqizimin e Vendimit nr.156, datë 07.08.2023, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.*

Lidhur me këtë çështje, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, është shprehur me Vendimin nr. 3248, datë 26.09.2024, nëpërmjet të cilit ka vendosur: *“Kthimin e kërkesë-padisë dhe të akteve që i përkasin çështjes administrative me palë paditëse “Illyrian Guard” sha”, vendim i cili ka marrë formë të prerë me datë 21.10.2024<sup>4</sup>, dhe si i tillë ka fuqi detyruese për t’u zbatuar nga organet/institucionet të cilave u drejtohet.*

Me shkresën me nr. 686/10 prot., datë 18.10.2024, Shoqëria “Illyrian Guard” sha, ka informuar Komisionerin se, pasi u njoh me vendimin nr. 3248, datë 26.09.2024, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ka vendosur të marrë në konsideratë zbatimin e Vendimit të KMD-së, dhe të ftojë z. A. D, për diskutim për rikthimin e tij në një pozicion të përshtatshëm pune pranë Shoqërisë “Illyrian Guard” sha.

Nga komunikimi me subjektin ankues për sa më sipër, lidhur me masat e Shoqërisë për zbatimin e Vendimit të KMD-së, Komisioneri është njohur nga z. D, me faktin se atij i janë propozuar disa pozicione pune, jo të njëjta apo të ngjashme me pozicionin që mbante para largimit nga puna, dhe se pozicionet e propozuara nuk janë në përputhje me arsimimin e kualifikimin e tij.

Në këto kushte, Komisioneri, me shkresën me nr. 1702 prot., datë 23.12.2024, ka kërkuar sërish nga ana e Shoqërisë “Illyrian Guard” sha, të paraqesë para KMD-së, informacionin e saktë dhe dokumentacionin provues, lidhur me masat konkrete të ndërmarra për zbatimin e Vendimit nr. 156, datë 07.08.2023, të KMD-së, duke rikthyer subjektin ankues në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të. Apo, nëse ndërmjet palëve (Shoqërisë dhe subjektit ankues) është arritur ndonjë marrëveshje me mirëkuptim, lidhur me punësimin e tij, t’ja komunikoni KMD-së këtë fakt.

Me shkresën me nr. 83 prot., datë 10.01.2025, Shoqëria “Illyrian Guard” sha, informon Komisionerin, ndër të tjera, si më poshtë vijon:

*“Pasi Shoqëria ka vendosur të marrë në konsideratë Vendimin e KMD-së, ka ngritur një grup pune për evidentimin e vendeve vakante dhe ka ftuar për takim z. D.*

*Është paraqitur avokati i z. D, ku i janë bërë me dije vendet vakante dhe nga ana e tij u sugjerua që këto vende t’i propozoheshin z. D nëpërmjet postës elektronike, pasi ndodhet në Amerikë.*

*Gjatë korrespondencës që patëm me e-mail në datën 28.10.2024 me z. D, nuk u arrit një konsensus në lidhje me rikthimin e tij në punë, në asnjë nga vendet vakante të propozuara nga ana jonë.*

<sup>4</sup> Konfirmuar nga K/Sekretaria e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë 29.10.2024.

*Sikurse është bërë me dije edhe z. D, me ndryshimin e strukturës dhe miratimin e organikës së Shoqërisë “Illyrian Guard” sha, me datë 07.04.2024, është bërë riorganizimi i disa funksioneve duke përfshirë edhe ndryshimin e emërtesës dhe përshkrimin e detyrave të funksionit që ka mbajtur z. D, dhe ky pozicion pune nuk ekziston në strukturën e Shoqërisë. Sa më sipër, është i pamundur rikthimi i z. D në pozicionin e mëparshëm të punës.*

*Aktualisht në Shoqëri, nuk ka asnjë pozicion vakant të barazvlefshëm me pozicionin e mbajtur prej tij dhe të përshtatshëm me kualifikimet e tij.*

*Sikurse kemi njoftuar edhe më herët z. D, në çdo hapësirë që do të krijohet në Shoqëri, duke mbajtur në vëmendje formimin dhe kriteret që z. D përmbush, do të jetë personi i parë që do të kontaktohet për të shqyrtuar mundësinë për një pozicion të barazvlefshëm me pozicionin e mbajtur prej tij.”*

Për sa më sipër, nëpërmjet shkresës me nr. 83 prot., datë 10.01.2025, Shoqëria “Illyrian Guard” sha, ka informuar Komisionerin për pamundësinë e zbatimit të Vendimit nr. 156, datë 07.08.2023, me anë të të cilit ka vendosur: “Konstatimin e diskriminimit të subjektit ankues, A. D, në të drejtën për punësim, për shkak të konfliktit të krijuar mes tij dhe punëdhënësit, klasifikuar si “çdo shkak tjetër”, nga ana e Administratorit të Shoqërisë “Illyrian Guard” sha.”, vendim i cili është i detyrueshëm për ekzekutim, pasi është lënë në fuqi me vendim të formës së prerë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Në këto kushte, si dhe bazuar në nenin 33/11, të ligjit nr. 10221/2010 “Per Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “Nëse Komisioneri urdhëron rregullime ose masa, personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, raporton brenda 30 ditëve para Komisionerit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit. Në rast se personi, kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk e informon Komisionerin ose nuk e zbaton vendimin, Komisioneri vendos masë për ndëshkimin me gjobë për personin kundër të cilit është paraqitur ankesa. Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni”, Komisioneri konsideron të pazbatuar efektivisht Vendimin e tij me nr. 156, datë 07.08.2023.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 32/1, shkronja “ç”, neni 33, pikat 11, 12, 13/a dhe 14, si dhe nenin 33/1, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

1. Subjekti i Shoqërisë “Illyrian Guard” sha, të gjobitet në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë.

2. Gjeba të derdhet në Buxhetin e Shtetit, brenda 45 ditëve nga komunikimi i masës administrative. Pagesa e kësaj vlere të bëhet pranë çdo banke në llogarinë e thesarit Tiranë, për llogari të: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, NIPT: L02027451K, Kodi: 1091001, Entiteti i Qeverisjes: 001, Distrikti (TDO) 3535, Llogaria ekonomike: 7115499.
3. Zbatimi i Vendimit nr. 156, datë 07.08.2023, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, brenda shtatë ditëve nga marrja dijeni për sanksionet, sjell shfuqizimin e tij.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në gjykatë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurave Administrative, të ndryshuar.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**